



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Proces verbal

Sot me datë 18.06.2025 ora 13:00 ishte parashikuar mbledhja e **Kryesisë së Këshillit Bashkiak** për shqyrtimin e rendit të ditës për mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak.

Të pranishëm janë:

Z. Oltion Luli
Znj. Irena Shala
Znj. Valjeta Bajraktari

Mungon:

Z. Gjergj Sokoli
Znj. Violeta Perndrecaj
Z. Edmond Ndou

Kourumi i domosdoshëm për zhvillimin e mbledhjes nuk është prezent, prandaj **Z.Luli** në cilësinë e Kryetarit vijon me citimin e rendin të ditës, që parashikohet për mbledhjen ardhshme të Këshillit Bashkiak, pjesë kjo që kryhet nga kryesia e Këshillit. Po ashtu **Z.Luli** vendos edhe për datën e mbledhjes, e cila do të mbahet ditën e Mërkurë, datë 25.06.2025 ora 17:00 me rend dite si më poshtë:

Miratimi i Procesverbalit të Mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak datë, 29.05.2025 sipas ligjit Nr.8480 datë, 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 16 pika 2.

1. *Pr/Vendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Maj 2025”.*
2. *Projektvendim: “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar”.*
3. *Projektvendim: “Për një ndryshim në VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar”.*
4. *Projektvendim: “Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Shkodër”.*
5. *Projektvendim: “Për miratimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Shkodër”.*

6. *Projektvendim: "Për një shtesë dhe ndryshim në VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar".*
7. *Projektvendim: "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri".*
8. *Projektvendim: "Për miratimin e kriterëve dhe për caktimin e rrugëve dhe shesheve publike për administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në Velipojë dhe Shirokë, të Bashkisë Shkodër".*
9. *Projektvendim: "Për miratimin e rrjetit të linjave, stacioneve të qëndrimit dhe të tarifës së biletave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në Bashkinë Shkodër".*
10. *Projektvendim: "Për miratimin e rregullores së përdorimit të hapësirës publike në Bashkinë Shkodër".*
11. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Zbardhi Proces verbalin:

Irma Sulishti



**SEKRETARE
Sabina DANAJ**

